



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.Shk.II.nr.538/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami në çështjen përmbartimore të kreditorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, me seli, në rr. “Armend Daci” nr.1, në Prishtinë kundër debitorit Ndërmarrja Prodhuese Tregtare “Grinta” me NRB:80040598, me pronar Gani Ferizaj, me seli në fshatin Jabllanicë e Madhe, Pejë, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1383/22 të datës 22.01.2024, me datë 07.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit Ndërmarrja Prodhuese Tregtare “Grinta” ndërsa aktvendimi Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1383/22 të datës 22.01.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar, KPPP.nr.1383/22 të datës 22.01.2024, në dispozitivin e aktvendimit e ka hedhë poshtë si të pa afatshëm prapësimin e debitorit Ndërmarrja Prodhuese Tregtare “Grinta” me NRB:80040598, i ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.301/21 të datës 13.08.2021 të Përmbartuesit Privat Blerim Baloku.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1383/22 të datës 22.01.2024.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

- **Ankesa e debitorit është e pathemeltë.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditor Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, me seli në Prishtinë ka paraqitur propozim për përmbartim në bazë të dokumentit të besueshëm në

bazë të dokumentit përbarues - Aktvendimit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale Nr.5471, të datës 20.12.2020, me të cilën është urdhëruar debitori që t'ia paguaj kreditorit në emër të rentës minerare në shumë prej 993.00 € (nëntëqind e nëntëdhjetë e tre euro), duke përfshi edhe rrjedhën e interesit mujor 2 %, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore me ndalim të mjeteve në para të cilat debitori i ka në të gjitha llogaritë bankare dhe bartjen e shumës përkatëse në llogaritë e kreditorit, si dhe regjistrimin, konfiskimin, dhe shitjen publike të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe nga shitja e këtyre të realizohet borxhi ndaj kreditorit si dhe të paguhen shpenzimet e procedurës përbarimore në pajtim me tarifën në fuqi.

Debitori ka parashtuar prapësim përmes të cilit e kundërshton urdhrin përbarimor, ndër të tjerash ka theksuar se borxhi i kërkuar nga kreditorit për vitin 2005, 2006 dhe 2007 ka arritur parashkrimin absolut dhe i njëjti nuk mund të kërkohej pasi të ketë skaduar afati kohor i paraparë me ligj dhe se borxhi i kërkuar nga ana e kreditorit është jo ligjor duke qenë se i njëjti është në kundërshtim me Ligjin 05/L-043 për Faljen e Borxheve Publike. Ka shtuar se debitori e ka pezulluar punën e tij që në vitin 2008 për shkak të mungesës së rezervave minerare dhe që nga ajo kohë kanë kaluar më shumë se 10 vite për çfarë edhe vet e drejta e kreditorit ka arritur parashkrimin absolut. I ka propozuar gjykatës që prapësimin e debitorit ta aprovoj si të bazuar dhe të anulohen të gjitha veprimet tjera.

Kreditori në përgjigje në prapësim të ushtruar brenda afatit ligjor, i ka kundërshtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, ndër të tjerash ka theksuar se prapësimi i debitorit nuk përmban kurrfarë arsytimi të bazuar në fakte dhe prova. Më tutje ka deklaruar se nuk qëndron pretendimi se i ka kryer të gjitha obligimet ndaj kreditorit ngase i njëjti nuk e ka paguar borxhin si në propozim dhe me qëllim që ti shmanget detyrimit ka tentuar të paraqes një gjendje faktike tjetër të pa bazuar dhe jo të mbështetur në prova. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet si i pa bazuar prapësimi i debitorit dhe të mbetet në fuqi urdhri përbarimor.

Gjykata Komerciale, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1383/22 të datës 22.01.2024, ku në dispozitivin e aktvendimit e ka hedhë poshtë si të pa afatshëm prapësimin e debitorit Ndërmarrja Prodhuese Tregtare "Grinta" me NRB:80040598, i ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.301/21 të datës 13.08.2021 të Përbaruesit Privat Blerim Baloku.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata ka vlerësuar se në rastin konkret debitori urdhrin përbarimor P.nr.301/21 të datës 13.08.2021, e ka pranuar me datën 23.08.2021, ndërsa afati për paraqitjen e prapësimit ka filluar të rrjedhë nga data 24.08.2021, rezulton se dita e fundit për paraqitjen e prapësimit ka qenë data 30.08.2021. Meqenëse në rastin konkret debitori prapësimin e ka paraqitur me datën 31.08.2021, në zyrën e përbaruesit privat, ndërsa në shkresë të lëndës nuk ka prova se prapësimi është dorëzuar edhe në mënyra tjera të përcaktuara për dërgimin e shkresave, rezulton se debitori prapësimin e ka paraqitur me një ditë vonesë.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar

nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë nuk i ka pranuar pretendimet ankimore për shkelje të dispozitave të ligjit të procedurës përmbartimore, pasi që gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar drejtë provat të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës të ofruara nga ndërgjyqësit, ka vendosur drejtë në dispozitiv të aktvendimit, duke dhënë arsye përkatëse në pjesën arsyetuese të aktvendimit të atakuar dhe drejtë ka aplikuar nenin 70 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore me të cilin përcaktohet se *“Prapësimi duhet t’i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbartues ose urdhrin përmbartues”*, ndërsa me nenin 126 par. 2 të LPK-së, përcaktohet se *“Në qofte se afati është caktuar me ditë, përjashtohet nga llogaritja dita në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të filloj afati, kështu që për fillim të afatit merret dita e parë e ardhshme.”* me të cilin interpretim është pajtuar edhe gjykata e shkallës së parë sepse debitori urdhrin përmbartimor P.nr.301/21 të datës 13.08.2021, e ka pranuar me datën 23.08.2021, ndërsa afati për paraqitjen e prapësimin ka filluar të rrjedhë nga data 24.08.2021, rezulton se dita e fundit për paraqitjen e prapësimin ka qenë data 30.08.2021. Ndërsa në shkresa të lëndës nuk ka prova se prapësimi është dorëzuar edhe në mënyra tjera të përcaktuara për dërgimin e shkresave, rezulton se debitori prapësimin e ka paraqitur me një ditë vonesë.

Prandaj me këtë rast kjo gjykatë vlerëson se debitori i përmbartimit ka rënë në vonese në paraqitjen e veprimin procedural prapësimin në këtë çështje përmbartimore.

Gjykata nuk i shqyrtoi pretendimet ankimore të debitorit të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, pasi që bazuar në shkresat e lëndës vërtetoi se prapësimi është i pa aftshëm andaj me të drejtë ka vendosur edhe gjykata e shkallës së parë.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika b) të LPK-së lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II nr.538/24 me datë 07.06.2024,

Gjyqtari

Faton Bajrami